

Sindikatë e re në Shtet të ri

Në Australi, ne kemi një histori të gjatë dhe të lavdishme sindikale dhe kemi përvojë të madhe gjatë rrugëtimit tone të gjatë që kemi luftuar për të ardhmen e anëtarëve tanë sindikal.

Por në qfarë situatë ndodhet një sindikatë e re kur shteti i saj nuk ka ekzistuar para 20 vitesh ?

Sindikata e ETU në Australi ka biseduar për këtë temë me kryetarin e sindikatës së Energjetikës së Kosovës , Fehmi Pajazitin, gjatë pjesëmarrjes së tij në Kongresin Sindikal Global të Energjetikës.

“Si shtet i saporformuar para shtatë viteve, ne jemi ende në krijim të institucioneve tona, përfshirë edhe sindikata,” tha mes tjerash z. Pajaziti.

Kosova u bë shtet i pavarur pas luftës civile dhe dhunës etnike e cila edhe i shpërbëri shtetet e ish Jugosllavisë.

Popullata në Kosovë është 90% shqipëtare, ndërsa 10 % ka minoritete Serb, Turk dhe Romë.

Përpjekjet për ti bindur punëtorët se së bashku janë më të fuqishëm dhe se duhet të kenë besim tek sindikatat pas tërë atyre viteve të vuajtura është po thajse një mission i pamundur.

“Në Kosovë, pa marrë parasysh se qfarë nacionalitet ke, je me fat nëse e kenë punë,” tha z. Pajaziti.

“Ne po punojmë që ti anëtarësojmë të gjithë punëtorët në sindikata. Po përpiqemi t’ia harrojmë të kaluarën dhe të koncentrohemi në krijimin e shtetit tone dhe sindikatave tona. Natyrisht kjo gjë është shumë e vështirë por mendojmë se do t’ia dalim disi.

Mos besimi është një sfidë e amdhe për ne se sit a kthejmë besimin e punëtorëve tek sindikatat. Ekonomia e Kosovës është në gjendje të rëndë dhe papunësia është diku rreth 50%.

Fatmirësisht kemi ligje të cilat e lejojnë organizimin e punëtorëve në sindikata dhe ky lligj na ndihmon të funksionojmë si duhet si organizatë sindikale. Por nganjëherë është e vështirë të punohet sepse këto ligje shpesh herë nuk implementohen fare në praktikë.

“I kemi ligjet, por është shumë i vështirë zbatimi i tyre në praktikë. Qfarëdo që bëjmë është një luftë e re. Ligjet që e ndihmojnë organizimin sindikal nuk respektohen shpesh herë,” tha z. Pajaziti.

“Për shembull, për shkak të problemeve që i kemi rreth papunësisë së madhe, punëtorët hezitojnë të luftojnë për të drejtat e tyre – pasi që frigohen të mos e humbin punën e për të gjetur një tjetër punë në Kosovë është shumë vështirë.

“Shpresoj shumë se mund të kemi angazhim më të madh të punëtorëve, që të jenë më aktivë dhe të luftojnë për më shumë të drejta sindikale.”

Z. Pajaziti përfaqëson rreth 2600 punëtorë të sektorit të distribucionit të energjisë elektrike, dhe thotë se rreth 80 % të punëtorëve janë anëtarë sindikal.

Dhe një qështje që u tha edhe gjatë fjalimit të z. Pajaziti në Kongresin Global në Australi është edhe fakti se shumë punëtorë e kanë humbur vendin e punës si rezultat i privatizimit dhe po vazhdojnë ta humbin. KEDS është privatizuar i tërë distribucioni pra në vitin 2013 dhe punëtorët e kanë të garantuar vendin e punës deri në maj të vitit 2016, më pas nuk dihet asgjë për fatin e tyre.

“Shumica e punëtorëve janë të mbrojtur vetëm nga kjo kontratë,” tha z. Pajaziti.

“Ne e dimë se menagjmenti veq se ka fillu planifikimin e atyre që do të shkojnë dhe atyre që do të mbesin. Dhe ne si sindikatë jemi në pozitë mjaft sfiduese se qfarë do të bëhet me punëtorët pas kësaj date, si t’i mbrojmë punëtorët ku menagjmenti ka mbështetjen e qeverisë tonë e jo punëtorët.

“Ne e dimë se na pret një luftë e gjatë dhe kemi nevoj për mbështetjen e të tjerëve, sidomos anëtarëve të këtij Rrjeti Global Sindikal të Energjisë Elektrike.

Të gjithë anëtarët e Rrjetit Global Sindikal këtë Kongres e shohin si experience me vlerë të madhe por për neve kjo është diqka vitale e papërshkrueshme. Sindikatat e Kosovës konsiderojnë se kanë nevojë për mbështetje Ndërkombëtare dhe solidaritet më shumë se sindikatat tjera të botës.

“Për neve është diqka shumë e mirë dhe e rrallë kur shofim se si sindikatat e vendeve tjera siq është Australia, Irlanda, Danimarka etj korrin suksese dhe rezultate të mira në benefit të punëtorëve përmes fushatave sindikale dhe aktiviteteve tjera,” tha z. Pajaziti.

“Përvojën që e kemi fituar gjatë këtij Kongresi Global në Australi do ta bartim tek kolegët tanë sindikal në Kosovë, sepse jemi të privilegjuar që ne si përfaqësues sindikal të një shteti asq të vogël kemi pas rastin të jemi pjesë e një familje aq të madhe sindikale siq është ky Rrjeti Global i Sindikatave të Energjisë Elektrike dhe i jemi shumë falendërues kolegëve tanë sindikal nga Australia që na e bënë të mundshme pjesëmarrjen tonë.

“Përvoja e fituar këtu dhe në kongreset e mëparshme në Dablin dhe në Kopenhagë, si dhe letrat mbështetëse nga ana juaj për protestën tonë kanë treguar solidaritet të lartë nga ju dhe kanë qenë mjaft të rëndësishme për neve.”

Natyrisht Kosova nuk i ka sindikatat aq të reja prej që jemi kriju si shtet, ne kemi qenë edhe pjesë e ish shtetit Jugosllav ku edhe atëherë ka pas sindikata por kanë qenë të organizuara në një system tjetër i cili ka qenë komunist.

“Tani sistemi ka ndërruar, shteti ynë po përpiqet që të punojë me standarde të BE-së dhe ne jemi në përpjekje të fuqizimit dhe modernizimit të sindikatave tona. ”

Z. Pajaziti ka shumë shpresa për një të ardhme më të mirë për anëtarët sindikal se do të organizohen dhe do të kenë besim më të madh tek sindikatat sepse është e vetmja mënyrë që të kemi sukses të mbrojmë njëri tjetrin, pra besueshmëria është element kyq për një sukses të madh.

“Në të ardhmen e afërt shpresoj se sindikatat do të bëjnë punën e vet, menagjmenti punën e vet dhe në marrëdhëniet punëdhënës punëmarrës do të ketë më shumë tolerancë, mirëkuptim dhe besim në të gjitha aspektet . Dhe se nuk do të na duhet të shpenzojmë aq shumë kohë dhe eneregji për të përmirësuar edhe gjërat e vogla për të mirë të punëtorëve.”

Fehmi Pajaziti

Kretar i FSPE